



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë, më 10.07.2019

Shtojca 16

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 10.07.2019]

Për: /“**BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE:”BAMI” sh.p.k**, me adrese ne Fushe Kruje Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R ,& “**CURRI” sh.p.k**, me adrese ne Tirane Vore Sharge, Pasuria nr.321/1/1, Zona Kadastrale nr.3319, Are me Siperfaqe 3500m2, me administrator Z Faik Curri, me NIPT J67902718S,perfaqesues i BOE subjekti ”**BAMI’ sh.p.k**]

Procedura e prokurimit: Procedure e Hapur .

Numri i referencës së procedurës: REF-23509-05-23-2019.

Fondi limit: : 315’137’849,2 (treqind e pesëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e teteqind e dyzet e nente presje dy) leke pa t.v.sh Financuar nga grantet qeveritare vene ne dispozicion nepermjet shkreses me nr 1492 prot date 17.05.2019 , te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise dhe AKUKIM(Agjensise Kombetare te Ujesjelles Kanalizimeve dhe Infrastruktures se Mbetjeve), me lënde "Detajim i buxhetit te viteve 2019-2021 per shpenzimet kapitale me financim te brendshem,per programin "Furnzimi me uje dhe kanalizime".

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“**Shtim i sasise se furnizimit me uje te Qytetit te Krujes”.**

Kohëzgjatja e kontratës: : 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): NUK KA .

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE:”BAMI” sh.p.k**, me adrese ne Fushe Kruje Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R ,& “**CURRI”**

sh.p.k, me adrese ne Tirane Vore Sharge, Pasuria nr.321/1/1, Zona Kadastrale nr.3319, Are me Siperfaqe 3500m2, me administrator Z Faik Curri, me NIPT J67902718S,perfaqesues i BOE subjekti ”**BAMI’ sh.p.k**.

- **VLERA E OFRUAR**= 313’761’558,10 (treqind e trembedhete milion e shtateqind e gjashtedhete e nje mije e peseqind e pesedhete e tete pike dhjete) leke pa tvsh.
- 2. “ **KUPA ” sh.p.k**, me adrese ne Tirane Kamez Rruga Berisha, Argjijatura me nr.pasurie 482, Çerkeze. me administrator Shkelqim Kupa, me Nipt K51615512C.
- **VLERA E OFRUAR**=314’969’726 (treqind e katermbedhete milion e nenteqind e gjashtedhete e nente mije e shtateqind e njezet e gjashte) leke pa t.v.sh .

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. “ **KUPA ” sh.p.k**, me adrese ne Tirane Kamez Rruga Berisha, Argjijatura me nr.pasurie 482, Çerkeze. me administrator Shkelqim Kupa, me Nipt K51615512C.
- **VLERA E OFRUAR**=314’969’726 (treqind e katermbedhete milion e nenteqind e gjashtedhete e nente mije e shtateqind e njezet e gjashte) leke pa t.v.sh .

Perkatesisht per keto arsye:

- Ne piken 2.3.1 te Dokumentave Standarte te Tenderit eshte kerkuar qe operatoret ekonomik pjesemafres duhet te vertetojne se kane realizuar gjate tri viteve te fundit punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur te fondit limit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar perkatesisht ne shumen prej **157’568’925** (njqind e pesedhete e shtate milion e peseqind e gjashtedhete e tete mije e nenteqind e njezet e pese) leke pa t.v.sh. Kontrata e sipermarrjes e paraqitur nga subjekti e nenshkruar me Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a me objekt “Ndertim i rrjetit shperndares dhe Kanalizimi ne zonen perball ish Uzines se Autotraktoreve (Shkoze e siperme deri ne Lanabregas), (Loti I)", nuk mund te merret ne konsiderate, pasi vlere e kontrates eshte nen 50% te vleres se fondit limit **157’568’925** (njqind e pesedhete e shtate milion e peseqind e gjashtedhete e tete mije e nenteqind e njezet e pese) leke pa t.v.sh, konkretisht 59,551,464 (pesedhete e nente milion e peseqind e pesedhete e nje mije e katerqind e gjashtedhjet e kater) leke pa t.v.sh
- Subjekti “ Kupa” sh.p.k nuk ka plotesuar nje nder kriteret me kryesore te percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit, konkretisht kriterin e parashikuar ne piken 2.3.13 te tyre. Operatori ekonomik nuk ka nje punesim mesatar prej 250 personash ne periudhen Janar 2018 – Prill 2019, por ka nje numer shume me te vogel se aq ne kundershtim me DST-ne e permendur me lart.

- Ne piken 2.3.3 te dokumentave standarte te tenderit eshte kerkuar qe shoqeria ofertuese duhet te paraqesi licensen e shoqerise te vlefshme per pikat dhe klasifikimin si me poshte vijon:

- N.P-1-C (Punime gërmimi në tokë)
- N.P-2-E (Ndertime civile dhe industriale)
- N.P-4- B (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale).
- N.P-7- E (Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje).
- N.P-12-C (Punime të inxhinierisë së mjedisit).
- N.S-18- B (Punime topogjeodezike)

Nga vleresimi i dokumentacionit te paraqitur rezulton qe subjekti nuk permbush kriteret e vendosura me sipër ne lidhje me disa kategori te punimeve. Konkretisht per NP-2(Ndertime civile dhe industrial, subjekti disponon klasifikimin D, ndersa ne dokumentat standarte te tenderit eshte kerkuar klasifikimi E . Per kategorine N.P-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit), subjekti disponon klasifikimin A, nderkohe qe eshte kerkuar klasifikimi C. Si edhe per kategorine N.S-18 (Punime Topogjeodezike), subjekti disponon klasifikimin A, ku ne DST eshte kerkuar klasifikimi B.

- Ne piken 2.3.5 te Dokumentave Standarte te tenderit eshte kerkuar qe Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar ne perberje te shoqerise stafin teknik për kryerjen e punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune te vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt) , diplomë, dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise tre muajt e fundit te deklarimit drejtuesit teknik si më poshtë:

- a. 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik
- b. 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- c. 2 (dy) Inxhinier Gjeodet
- d. 1 (një) Inxhinier Elektrik
- e. 2 (dy) Inxhinier Mekanik
- f. 2 (dy) Inxhinier Mjedisi
- g. 2 (dy) Inxhinier Gjeolog

Nga verifikimi i KVO-se, rezulton se subjekti ne kundershtim me kete pike te DST-se, ka paraqitur dokumentacionin ku verteton se ka ne perberje te stafit vetem nje Inxhinier hidroteknik Z. Edmir Sula, nga dy te kerkuar ne DST. Ka paraqitur vetem nje inxhinier ndertimi Znj. Entela Buzi, nga dy te kerkuar. Ka paraqitur dokumenta vetem nje inxhinier gjeodet Z. Josif Bardhoshi, nga dy te kerkuar. Ka paraqitur dokumenta vetem per nje inxhinier gjeolog Z. Jonual Kristo, nga dy te kerkuar. Ka paraqitur vetem nje inxhinier mjedisi Znj. Erjola Duka, nga dy te kerkuar. Ka paraqitur vetem nje inxhinier mekanik Z. Ervin Isaj, nga dy te kerkuar.

- Ne kundershtim me piken 2.3.6 te dokumentave standarte te tenderit, operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaraten me shkrim nga ana e administratorit te shoqerise se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5,a) per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera qe operatori ekonomik ka aktualisht ne proces zbatimi dhe nuk duhet te jene te punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror apo privat, ne rast se shpallen fitues per kete procedure,si dhe do te qendrojne ne objekt gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve.
- Ne kundershtim me piken 2.3.7 te dokumentave standarte te tenderit, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin perkates per te vertetuar se ne perberje te stafit te tij ka te pakten nje inxhinier specialist pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune. si edhe ne kundershtim me piken 2.3.11 te dokumentave standarte te tenderit subjekti nuk ka paraqitur asnje dokument ligjor qe verteton se ne perberje te stafit te tij ka nje ekspert zjarrefikes te pajisur me license te vlefshme per ushtrimin e profesonit.
- Ne kundershtim me piken 2.3.15/b te dokumentave standarte te tenderit, operatori ekonomik nuk ka paraqitur Liçencen e lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçensimit (QKL), Kodi III.2.A (1+2) “Veprimtarite e vleresimit te ndikimit ne mjedis.”
- Subjekti ne kundershtim me piken 2.3.19 te DST-se ofertuesi nuk ka paraqitur asnje nga certifikatat e standartizimit te kerkuara.
- Ne piken 2.3.10 te Dokumentave Standarte te tenderit eshte kerkuar qe operatori ekonomik ofertues duhet te ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme pergjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates, deshmi kualifikimi nga organet perkatese kompetente,deshmit e drejtimit perkatese dhe të figurojnë në listëpagesa 3 (tre) muajt e fundit, 16 (gjashtembedhjete) Manovrator per mjetet e makinerit e renda, si dhe 15 (pesmebedhjete) shofere kamionesh. Ne kundershtim me kete pike te DST-se subjekti ka paraqitur dokumentacionin perkates ligjor vetem per kater manovratore nga 16 te kerkuar, konkretisht per Z. Mustaf Logu, Z. Hekuran Mema, Z. Albert Mankollari, Z. Qazim Laci, si edhe per 5 shofere nga 15 te kerkuar, konkretisht Z. Rakip Gjici, Z.Adrian Lami, Z. Dulejman Pasha, Z. Shpetim Xhixha, Z Artan Disha.
- Ne piken 2.3.14 te dokumentave standarte te tenderit eshte kerkuar qe operatori ekonomik duhet te kete te punesuar ne ne stafin e tij me kontrata respektive pune dhe te pasqyruara edhe ne listpagesa te tre muajve te fundit te deklarimit e te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente të autorizuar me ligj, personel te trajnuar si me poshte vijon:
 - (kater) punonjës Hidraulikë
 - (kater) punonjës Saldator
 - 2 (dy) punonjës Mekanik

- (tre) teknik Ndertimi
- 2 (dy) teknik Ndertimi topograf
- 10 (dhjete) Punëtor ndertimi

- Ne kundërshtim m ekete pike te DST-se Subjekti "Kupa" sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar ku verteton se ka ne stafin e tij vetem tre saldatore nga kater te kerkuar, vetem dy mekanike nga kater te kerkuar, vetem nje teknik ndertimi nga tre te kerkuar.

- Ne piken 2.3.16 te dokumentave standarte te tenderit eshte kerkuar qe operatori ekonomik fitues duhet te disponoje ne pronesi ose ne qera kamiona ne kapacitetin mbajtes minimumi 20 ton. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor vetem per kater kamiona me kapacitet mbajtes mbi 20 ton. Subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor vetem per nje kamioncine nga pese te kerkuara. Po ashtu operatori ekonomik ka vertetuar se disponon vetem nje autobot uji, nga tre te kerkuar.

- Pervec mjeteve te permendura me lart, subjekti : "Kupa" sh.p.k nuk ka paraqitur asnje dokument ligjor qe te vertetoje posedimin ne pronesi apo me qera te mjeteve te nevojshme per kryerjen e punimeve te kerkuara ne piken 2.3.16 te dokumentave standarte te tenderit.

- Ne kundërshtim me piken 2.3.17 te dokumentave standarte te tenderit subjekti nuk ka paraqitur Vertetimin e leshuar nga bashkia kruje, qe verteton realizimin e vizites ne kantier nga ana e subjektit ne daten e percaktuar ne DST.

- Ne piken 2.1/b te dokumentave standarte te tenderit eshte kerkuar qe cdo operator ekonomik ofertues nuk duhet te kete detyrime te papaguara vendore, detyrime te ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime te ngarkuara nga organe te tjera ne favor te Bashkise Krujë dhe të Njësite Administrative (ish Komuna dhe Bashki që i jane bashkuar Bashkise Krujë). Per te plotësuar kriterin e mesiperm Operoret ekonomik pjesëmarrës duhet te paraqesin vertetimin perkates leshuar nga administrata tatimore e Bashkise Kruje, qe subjekti nuk rezulton te kete detyrime. Subjekti "Kupa " sh.p.k nuk ka paraqitur asnje vertetim per te vertetuar se ai nuk ka detyrime ndaj Bashkise Kruje.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**"BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE:"BAMI" sh.p.k**, me adrese ne Fushe Kruje Kameras me administrator Z. Besnik Bami , me NIPT J94416206R ,& **"CURRI" sh.p.k**, me adrese ne Tirane Vore Sharge,

Pasuria nr.321/1/1, Zona Kadastrale nr.3319, Are me Siperfaqe 3500m2, me administrator Z Faik Curri, me NIPT J67902718S,perfaqesues i BOE subjekti "BAMI" sh.p.k / se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 313'761'558,10 (treqind e trembedhete milion e shtateqind e gjashtedhete e nje mije e peseqind e pesedhete e tete pike dhjete) leke pa tvsh /pikët totale të marra [ska], është identifikuar si oferta e suksesshme .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Kruje, Qender Sheshi "Mustafa Merlika (Kruja), prane Zyres se Njesise se Prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [nuk ka operatore ekonomik te tjere te klasifikuar], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **02.07.2019**

Ankesa: ka ose jo: { JO }

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Krujë, nuk u paraqit asnjë ankesë sipas formularit përkatës.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ARTUR BUSHI**